


KOMUNA RAHOVEC

BULETINI MUJOR KOMUNAL SHKURT 2020



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINETI I REDHEDEKATIT OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 349 Nr.faq./Br.str./No.pg 36
Data/Datum/Date 02.03.2020
RAHOVEC / ORAHOVAC

2020

Buletini mujor komunal është botim që përgatitet si rregull një herë në muaj dhe përmban: Aktivitetet, punët dhe angazhimet e Kryetarit të Komunës dhe drejtorëve të drejtorive komunale, të cilat janë realizuar përgjatë muajit shkurt.



PËRMBAJTJA

HYRJE	2
PËRMBLEDHJE E AKTIVITETEVE GJATË MUAJIT SHKURT	2
Publikimi i dokumenteve me rëndësi për Komunën e Rahovecit	2
Aktivitete të rëndësishme të Kryetarit dhe drejtorëve të drejtorive shkurt 2020	3
PËRFUNDIM	13



HYRJE

Ky organ botues është krijuar me idenë fillestare të promovimit të aktiviteteve të Kryetarit të Komunës dhe drejtorëve të drejtorive përgjatë muajve të vitit 2020, rëndësia e botimit të buletinit disa herë në vit qëndron në dhënien e mundësisë për informacionet mbi vendimet, zbatimin e politikave dhe rezultatet e aktiviteteve të Komunës së Rahovecit në mënyrë të tillë që të mundësojmë që qytetari të ndjekë dhe të kontribuojë në mënyrë efektive në punën e institucioneve lokale.

PËRMBLEDHJE E AKTIVITETEVE GJATË MUAJIT SHKURT**Publikimi i dokumenteve me rëndësi për Komunën e Rahovecit**

LISTA E VENDIMEVE TË NËNSHKRUARA NGA KRYETARI I KOMUNËS SË RAHOVECIT, z.SMAJL LATIFI PËR MUAJIN SHKURT 2020.

Nr	Nr.protokolit i vendimeve të Kryetarit Smajl Latifi dhe datat e marrjes së vendimeve
1	02/263/2020 Datë: 03.02.2020
2	02/268/2020 Datë: 05.02.2020
3	02/270/2020 Datë: 07.02.2020
4	02/274/2020 Datë: 07.02.2020
5	02/276/2020 Datë: 10.02.2020
6	02/278/2020 Datë: 10.02.2020
7	02/279/2020 Datë: 10.02.2020
8	02/280/2020 Datë: 10.02.2020
9	02/281/2020 Datë: 10.02.2020
10	02/283/2020 Datë: 12.02.2020
11	02/285/2020 Datë: 14.02.2020
12	02/287/2020 Datë: 14.02.2020
13	02/288/2020 Datë: 19.02.2020
14	02/289/2020 Datë: 20.02.2020
15	02/290/2020 Datë: 21.02.2020
16	02/292/2020 Datë: 25.02.2020
17	02/298/2020 Datë: 25.02.2020
18	02/305/2020 Datë: 27.02.2020
19	02/306/2020 Datë: 27.02.2020
20	02/307/2020 Datë: 27.02.2020
21	02/334/2020 Datë: 28.02.2020

Vendimet e Kryetarit të Komunës së Rahovecit i gjeni të publikuara në ueb-faqen e Komunës së Rahovecit.

Aktivitetet e rëndësishme të Kryetarit dhe drejtorëve të drejtorive shkurt 2020



Komuna e Rahovecit, përkatësisht drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka bërë shpërndarjen e mekanizmave bujqësor: 301 motokultivatorë (benasë). Nga kjo fazë dhe nga fazat e tjera të shpërndarjes kanë përfituar motokultivatorë, gjithsej 361 fermerë, të cilët do ta kenë më të lehtë të fillojnë punët e tyre përgatitore për këtë sezonë dhe të kenë prodhimtari cilësore. Përkujtojmë faktin se, në 6 faza të shpërndarjes, për 12 lloje të pajisjeve, veglave dhe të mekanizmit bujqësor, kanë përfituar 812 fermerë.



Bashkë me drejtoreshën për Administratë të Përgjithshme dhe drejtorin e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Kryetari z. Smajl Latifi mbajti takimin e parë periodik me shërbyesit civil, për vitin 2020. Në takim u kërkuar që të respektohet orari i punës si kusht parësor për një administratë publike të qëndrueshme, të ketë rregull dhe zbatim të plotë të ligjit dhe etikës së punës dhe ekonomizim të shpenzimeve-për një komunë edhe më funksionale dhe shërbime sa më cilësore.

Në bazë të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës, më datë: 10.02.2020, Kryetari z. Smajl Latifi mori vendim për formimin e 5 (pesë) komisioneve Ad-hoc, me gjithsej 15 (pesëmbëdhjetë) anëtarë, për verifikimin e mekanizmave bujqësor të shpërndarë nga Komuna e Rahovecit. Pas përfundimit të punës, secili kryesues i komisionit bëri raport të detajuar dhe nga të gjeturat doli që: Nga 812 pajisje bujqësore, 7 prej tyre janë keqpërdorur që në përqindje i bie 0,86% në gjithë territorin e komunës së Rahovecit. Ndaj këtyre përfituesve të cilët kanë bërë keqpërdorime do të merren masa të duhura ligjore me të cilat do të dënohet ky veprim jashtë kornizave ligjore dhe etikës njerëzore.





Në prani të Nënkryetarit, z.Fatmir Iska dhe u.d. të shefit të Zyrës së Prokurimit, z. Astrit Mullabazi, Kryetari z. Smajl Latifi takoi operatorët ekonomik me të cilët Komuna e Rahovecit ka marrëdhënie kontraktuale. Në fillim të këtij viti, me fillimin e sezonës së punimeve Kryetari z.Smajl Latifi kërkoi që të dinamizohen dhe të kryhen me kohë punimet në projektet ekzistuese dhe të tjerat që do t'i kontraktojmë. Në vazhdimësi Kryetari z.Smajl Latifi kërkoi që të shtohet cilësia e punimeve dhe së bashku të bëjmë punë të suksesshme në të mirë të komunitetit.



Kryetari z.Smajl Latifi ka nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Projektit "Subvencionet për Eficiencë të Energjisë në Kosovë-SEEK" dhe Komunës së Rahovecit. Projekti ka për qëllim të zvogëlojë konsumin e energjisë elektrike në sektorin e banimit duke ndarë subvencione dhe stimuj të tjerë ekonomik për njësitë e banimit që të investojnë në masa të Eficiencës së Energjisë dhe në Burime të Ripërtërishme të Energjisë, nëpërmjet pakos ndërhyrëse Renovimet për Eficiencë në Njesitë e Banimit.



Në mënyrë të vazhdueshme konsultohemi me përfaqësues të UN-Habitatit për përgaditjen e konkursit ndërkombëtar për projektimin e sheshit të qytetit në Rahovec. Në kuadër të këtyre konsultave, drejtori i DUPMM-së z. Rumir Zhuniqi takoi Planerin urban të kësaj organizate, Arion Xhemaj si dhe bashkëpunëtoren e tij për zhvillim urban, Blerina Boshnjakun, të cilët janë vendosur në Drejtorinë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit për të na mbështetur në përgaditjen e shpalljes së konkursit. Mbetemi me përkushtim të palëkundur që Rahovecin ta bëjmë me shesh, duke iu

përmbajtur standardeve e procedurave që garantojnë kualitet e transparencë.



Falë motit të mirë që ka mbretëruar deri më sot në këto ditë dimri, punët në ndërtimin e kullës kushtuar dy heronjve nga Rahoveci, Tonit dhe Mici, kanë vazhduar. Punimet për ndërtimin e këtij objekti kanë nisur në 21-vjetorin e rënies së tyre. Jemi të përkushtuar që punimet të vazhdojnë dhe të përfundojnë sipas kohës së paraparë.

Grupi punues për hartimin e Rregullores për Taksa Komunale, i kryesuar nga Drejtori për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit, Afrim Limani, ka mbajtur takimin e radhës.



Rregullimi oborrit të "Shtëpisë së Fshatit" në Senoc. Investim nga Komuna e Rahovecit.



Në 12-vjetorin të shpalljes së Pavarësisë së shtetit tonë të pavarur e sovran, Kryetari z.Smajl Latifi me bashkëpunëtorë, invalidë e veteranë, me qytetarë të venbanimeve të komunës së Rahovecit, bënë homazhe në të gjitha vendlërit e dëshmorëve. Në këtë ditë nderuam e përkujtuam me përkushtim të lartë gjakun dhe veprën atdhetare të të rënëve, duke mbajtur edhe një Seancë Solemne të Kuvendit Komunal, mbajtëm një akademi përkujtimore në Rahovec, poashtu, vizituam Shtëpinë Muze të Ukshin Hotit dhe nderuam veprën e pavdekshme të profesorit.



Kryetari z. Smajl Latifi çdo të enjte takon qytetarë të shumtë nga komuna e Rahovecit, për të dëgjuar secilin veç e veç për hallet, shqetësimet dhe kërkesat e tyre.

Takimet e ngjashme me qytetarë do të vazhdojnë edhe në të ardhmen.



Zgjerimi dhe rregullimi i rrjetit të kanalizimit në fshatin Dobidol.



Në qytetin e Rahovecit, do të instalohen kamerat në tërë qytetin si dhe në disa kryqëzime rrugore si në fshatin Xërxë, ku ky sistem do të shërbejë në sigurinë e qytetarëve.


Monitorimi do të bëhet nga stacioni policor në Rahovec.



Pamje- Ndërtimi i segmentit rrugor në Rahovec.



Pamje- Ndërtimi i rrugës "Remzi Ukshini" në Rahovec.



Punimet të cilat janë duke u zhvilluar në vendin e quajtur "Tregu i Rrushit" po i japin atij një pamje të re dhe të përshtatshme për të plasuar produktet për shitje.

Komuna e Rahovecit respektivisht Drejtoria e Bujqësisë është e përkushtuar në maksimum, në mënyrë që fermerët të kenë një vend ku i plotëson të gjitha kushtet të cilat nevojiten për shitjen e produkteve të tyre.



Shoqata e Bletarëve "Nektar Rrushi" në bashkëpunim me DBPZHR-në, kanë mbajtur ligjërata me temën: "Sëmundjet e Bletëve" me ligjërues Dr. Beqë Hulaj.

Drejtori Duraku është shprehur para bletarëve se DBPZHR-ja, këtë vit ka përgatitur planin punues ku edhe do të vazhdojë me përkrahjen e bletarëve me pajisje të ndryshme në mënyrë që ti lehtësojnë punët dhe të rrisin kualitetin e prodhimit.



Në kuadër të shënimit të 12-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, DKRS në bashkëpunim me SHL- K, organizoi gara në futboll mes katër shkollave të futbollit që veprojnë në komunën e Rahovecit. Në gara morën pjesë fëmijët që kanë lindur në vitin e shpalljes së pavarësisë dhe viteve tjera.

Albina Krasniqi, futbolliste nga komuna e Rahovecit, u mirëprit në një takim nga Kryetari z.Smajl Latifi dhe drejtoresha znjsh.Bjondina Kleqka, meqë rast asaj ju nda një mirënjohje inkurajuese, me motivacion: "Për afirmimin e sportit të futbollit në komunën e Rahovecit".



Në vargun e aktiviteteve që ka zhvilluar Komuna e Rahovecit për nder të 17 Shkurtit-Ditës së Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, DKRS dhe DKA organizuan një tryezë diskutimi me historianë me temën " Arsimi shqip në Kosovë gjatë viteve të 90-a"!

Ndër komunitat e përzgjedhura për bashkëpunim dhe implementim të projekteve nga UN Mission in Kosovo, është edhe Komuna e Rahovecit. Së bashku me përfaqësues të UN, si dhe OJQ-të tona lokale, do të shërbejmë si urë lidhëse për të implementuar projektet që kanë për synim mbështetjen e të rinjve si agjentë kryesor të ndryshimit, duke promovuar kështu vullnetarizmin si dhe rritjen e barazisë ndër njerëzore.



Kanë filluar përgatitjet për Festivalin Sportiv të Parafillorëve 2020. Festivali do të mbledh fëmijët 5-vjeçarë, të cilët janë parafillorë nëpër institucione. Ata do të praktikojnë sportet e futbollit dhe disiplina të ndryshme të atletikës.



Vijojnë punimet e ndërtimit të objektit të shkollës fillore "Liria" në Fortesë.



Vazhdon ndërtimi i objektit të çerdhes për fëmijë në Krushë të Madhe.



Respektimi i orarit mësimor, vijimi i rregullt i procesit edukativ dhe arsimor, ngritja e përgjegjësisë së drejtorit të shkollës, mësimdhënësve, nxënësve dhe prindërve, ishin disa nga temat që i trajtoi drejtori i DKA-së z.Avni Morina në Shkollën e Mesme të Lartë "Ukshin Hoti" në Krushë të Madhe. Në këtë takim morën pjesë nxënës, prindër dhe mësimdhënës.

Punimet në Çerdhen e Fëmijëve në qytet pritet të rifillojnë së shpejti. Deri më tash ka përfunduar instalimi i radiatorëve të ngrohjes qendrore, por kalldaja ende nuk është instaluar. Poashtu, aty ka ende punë për t'u shtruar dyshemeja e korridoreve dhe klasave, ndërkohë që ishin instaluar e rregulluar pajisjet e nyjeve sanitare. Kujtojmë se ky është projekt i Ministrisë së Arsimit i mbështetur nga Banka Botërore dhe çerdhja do të jetë e standardeve më të larta bashkëkohore.





Në Shkollën e Mesme Profesionale "Selajdin Mullabazi-Mici" përruam 3 kabinete të pajisura për drejtimet profesionale, investime këto të DKA-së:

- Kabinetin e shkencave juridike
- Kabinetin e Teknologjisë Informative
- Kabinetin e Makinerisë



Vazhdoi në javën e tretë trajnimi në kuadër të projektit "Shkollat e shekullit 21" i mbështetur nga Këshilli Britanik (British Council), MASHT dhe DKA.

Tema e këtij trajnimi ishte " Shkathtësitë bazë në zhvillimin e lidërshpit". Në këtë trajnim kanë marrur pjesë të gjithë drejtorët e shkollave të komunës sonë.



Drejtoresha e Administratës znjsh. Saranda Sallteku dhe drejtori i DKA-së z.Avni Morina, zhvilluan një takim me kryetarin e SBASHK-ut degës në Rahovec z.Veli Morina ku bashkë biseduan rreth koordinimit të aktiviteteve, të cilat do t'i zhvillojmë për festën e 7 Marsit!

Projekti ASSET tashmë ka filluar të zbatohet praktikisht në Shkollën e Mesme të Lartë "Xhelal Hajda-Toni"- Rahovec, ASSET-i është iniciativë e dizajnuar të zhvillojë shkathtësi për punësim dhe ndërmarrësi tek të rinjtë, duke krijuar botëkuptim pozitiv për të ardhmen e tyre. Ky projekt realizohet pas marrëveshjes që kemi bërë me Qendrën për Arsim të Kosovës (KEC).





Pas zbatimit me përpikmëri të projektit të DKA-së me Bankën Botërore, Shkolla "Hamëz Thaçi" në Xërxë është pajisur me kabinetin e teknologjisë informative me 10 kompjuterë, videoprojektor dhe pajisje përcjellëse.



Shtëpia Botuese "Dukagjini", dhuroi 57 tituj librash të rinjë me nga 7 copë, gjithsej 399 copë libra për nxënësit e SHML "12 MAJI".

Në emër të DKA-së, drejtori i DKA-së, z.Avni Morina falënderoi shtëpinë botuese "Dukagjini" për këtë dhuratë të çmuar për nxënësit e komunës sonë.



Në takim me Drejtorin Ekzekutiv të Iniciativës për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës IADK, z. Zenel Bunjaku, Kryetari z.Smajl Latifi ka pranuar Aneks Marrëveshjen për bashkëfinancim mes Komunës së Rahovecit dhe IADK-së. Marrëveshja ka për qëllim realizimin e bashkëfinancimit dhe mbështetjes së përfituesve potencial në kuadër të projektit për përfituesit të cilët janë rikthyer në komunën e Rahovecit.



Pas rreshjeve të borës kompanitë e kontraktuara nga Komuna e Rahovecit menjëherë kanë dalur në terren për pastrim të rrugëve, falë reagimit të shpejtë të kompanive nuk ka pasur vështirësi dhe pengesa në qarkullim të lirë të automjeteve!



Është mbajtur takimi i parë i ekipit komunal për planifikimin e sheshit qendror të qytetit tonë. Në takim u diskutua për punët e arritura deri më tani, si dhe për përgaditjet për diskutimet që do të mbahen me qytetarë në fazën e re të procesit gjatë pjesës së dytë të muajit mars. Hap pas hapi, dhe në bashkëpunim të ngushtë me ekspertët e organizatës më të njohur në botë për planifikim UN-Habitat, projektin për ndërtimin e sheshit do ta bëjmë realitet potencoi drejtori z.Rumir Zhuniqi.



Është mbajtur mbledhja e dytë e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e thirrur nga kryesuesi i Kuvendit, z.Afrim Dina. Të pranishëm në këtë mbledhje ishin: Kryetari z.Smajl Latifi, Nënkryetari, z.Fatmir Iska, anëtarët e Kuvendit Komunal, drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësues nga OSBE-së, përfaqësuesit e LMT-së në Rahovec dhe nxënësit e Shkollës Profesionale "Selajdin Mullabazi-Mici" në Rahovec. Në këtë mbledhje u shqyrtuan dhe u aprovuan: 10 pika të rendit të ditës.

PËRFUNDIM

Ky buletin përmbledhës paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe (shkurt 2020).

Edhe pse fusha e qeverisjes së mirë është mjaft e gjerë, një aspekt i rëndësishëm i saj që është i pashmangshëm për ta plasuar qytetarin në vend qendror është liria e informimit. Informacioni është themeli i qeverisjes së mirë, jo vetëm sepse e rrit efikasitetin por gjithashtu sepse i fuqizon qytetarët dhe mundëson shpërndarje të barabartë të përfitimeve nga zhvillimi i përgjithshëm në vend, andaj duke dashur që të jetë sa më transparente me publikun, Komuna e Rahovecit përmes këtij dokumenti ka ofruar një pasqyrë të përgjithshme të aktiviteteve të saj, për t'iu dhënë mundësi qytetarëve që të njohin e vlerësojnë punën e institucioneve komunale.

Në nivelin lokal, mekanizmi i pjesëmarrjes së qytetarëve në bërjen e politikave është kriter bazë i demokracisë së drejtpërdrejtë të cilin duhet respektuar njësitë e vetëqeverisjes lokale.

Komuna e Rahovecit ka vënë në funksion këto parime përmes formave të ndryshme të komunikimit me qytetarë, takimeve të drejtpërdrejta, informimit publik dhe çfarëdo metode tjetër përmes së cilës transparenca të ndikojë në avancimin e vetëqeverisjes lokale.

Përveç konsultimit dhe komunikimit, këto dokumente forcojnë lidhjet e qytetarëve me komunën dhe rrisin besimin që e gëzojnë zyrtarët publik në nivel lokal.

Rahovec, 2 mars 2020

Zyra e Kryetarit _____

Komuna e Rahovecit/Opština Oraovac/Municipality of Rahovec

Adresa : Rr. 8 Dëshmorët e Pashtrikut p.n,21000,Rahovec –Kosovës Tel :0382004534 Email : komuna.rahovec@rks-gov.net